

4 nëntor 2025,
Prishtinë

Komesari i Garave për Kategoritë e Reja i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. I I /2025-26
I KOMESARIT TË GARAVE PËR KATEGORITË E REJA

- I. KB Reggio Basket Academy i paraqitur në Ligën U12 Lindje, largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në vitin e ardhshëm garues nuk mund të paraqitet në të njëjtën ligë të garave.**

ARSYETIM

Gjatë shqyrtimit të situatës së krijuar me ekipin KB Reggio Basket Academy në kuadër të Ligës U12 Lindje, Komesari i Garave për Kategoritë e Reja ka marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat e dokumentuara në raportet zyrtare të ndeshjeve dhe komunikimet përkatëse me klubin.

Ekipi i Reggio Basket Academy ka njoftuar Komesarin e Garave se nuk disponon numër të mjaftueshëm lojtarësh për zhvillimin e ndeshjeve të planifikuara. Megjithatë, pavarësisht arsyetimit të dhënë nga klubi, mungesa e numrit të nevojshëm të lojtarëve dhe mosparaqitja në ndeshje përbën shkelje të dispozitave të Propozicioneve të Garave të Ligave të Kategorive të Reja.


Gjatë vendimmarrjes lidhur me pikën I të Vendimit Nr. II /2025-26, Komesari i Garave për Kategoritë e Reja ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Në ndeshjen e Xhiros II Liga U12 Lindje-Perëndim ndërmjet KB Sigal Prishtina dhe Reggio Basket Academy, e zhvilluar me datë 02.11. 2025 në ora 10:00, ekipi i KB Reggio Basket Academy paraqitet vetëm me tetë lojtarë. Sipas nenit 4 të Propozicioneve të Garave të Ligave të Kategorive të Reja, gjegjësisht në lidhje me Ligën U12 Lindje-Perëndim, *“Në rast se skuadra vjen me më pak se 10 lojtarë/e, ndeshja nuk do të zhvillohet, ndërsa skuadra do të dënohet me (50 euro).”*
- (b) Në ndeshjen e Xhiros V Liga U12 Lindje-Perëndim ndërmjet KB Trepca Ipko dhe Reggio Basket Academy, e paraparë të zhvillohet me datë 22.11. 2025 në ora 17:00, ekipi i KB Reggio Basket Academy nuk është paraqitur për zhvillimin e ndeshjes.

- (c) Rrjedhimisht, mos-zhvillimi i ndeshjeve nga pikat (a) dhe (b) më lart ka rezultuar në regjistrimin e ndeshjeve të KB Reggio Basket Academy me rezultat zyrtar 20:00.
- (d) Në përputhje me Propozicionet e Garave të Ligave të Kategorive të Reja, "Ekipi që në një edicion garues humb 2 ndeshje të përshkruara me nenin 28.37. dhe 28.39. do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në vitin e ardhshëm garues nuk mund të paraqitet në të njëjtën ligë të garave".
- (e) Edhe pse neni 28.39 i Propozicioneve të Garave nuk e përshkruan në mënyrë specifike rastin kur ekipi nuk paraqitet për shkak të mungesës së lojtarëve, efekti sportiv dhe disiplinor është i njëjtë, ngase në të dy rastet rezultati i ndeshjes regjistrohet zyrtarisht me 20:0 dhe ndeshja konsiderohet e humbur.
- (f) Në këtë kuptim, zbatimi i nenit 28.39 bëhet analogjikisht, duke respektuar parimin e barazisë në trajtimin e ekipeve dhe konsistencën e zbatimit të rregullave.
- (g) Prandaj, pavarësisht se arsyeja e mos-zhvillimit është mungesa e lojtarëve, kjo situatë trajtohet si humbje me rezultat zyrtar, duke bërë që ekipi të përmbushë kushtet për largim nga garat e mëtutjeshme.

Xhelal **MUMINI**

Komesar i Garave për Kategoritë e Reja



Federata e Basketbollit të Kosovës



Këshillë Juridike:

Konform Nenit 24 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë e Reja, Edicioni 2025/2025, në vendimin e Komesarit të Garave është e lejuar ankesa në Komisionin e Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së, e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas pranimit të vendimit (përmes postës elektronike apo dita e publikimit në ueb-faqen e FBK-së). Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 150.00 €.